



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kryetarja e Komunës

01nr _____

Dt: 31.07.2015

Kryetarja e Komunës së Gjakovës , në bazë të nenit 11, 13 dhe 58. a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03L-040 , nenit 8,9 dhe 10 të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Komunale, si dhe në harmoni me rekomandimin e Komisionit për ndarjen e subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, për mbështetje financiare të Klubit të Atletikës “Vllaznimi” nga Gjakova, me dt:31.07.2015 e miraton këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Klubit të Atletikës “Vllaznimi” nga Gjakova nr. 10-400-44848 e dt: 07.07.2015, për subvencionimin e një pjese të shpenzimeve të këtij klubi për mbarëvajtjen e aktiviteteve sportive gjatë vitit 2015, duke e mbështetur këtë kërkesë me subvencione komunale në vlerë prej 500€.
2. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të realizon procedurën e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 500€, nga mjetet e fondit të subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë , Rini dhe Sport dhe bartjen e tyre në konton e Klubit të Atletikës “Vllaznimi” nga Gjakova nr. 17-04-001600064631 NLB Bank.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .

CO: - Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Klubit të Atletikës “Vllaznimi” nga Gjakova
- Arkivit

Kryetarja e Komunës

Znj. Mimoza Kusari-Lila

